



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:287494

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05825257

KF.nr.247/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit, “Gentipharm” ShPK me seli në Parku i Biznesit Drenas, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Rafet Ferizi avokat, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, vlerë kontesti 231,752.07 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor – Publik, të mbajtur me datë 17.05.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Avokat Rafet Ferizi, D.Sh. pronar i paditësit dhe V.Sh.R. drejtoreshë, dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Alberije Hoxha Dedushu, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit "Gentipharm" ShPK me numër të biznesit 70772833 me seli në fshatin Pozharan, Viti, si e bazuar.
- II. ANULOHET Aktvendimi 01.3.2.2/12816/2020 i datës 25.11.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe aktvendimi 03.1.1.2020/129/2 i datës 05.10.2020 me të cilin janë caktuar taksat shtesë, si vendim i pabazuar në ligj.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Paditësi, me padinë e paraqitur në Gjykatë më 21.12.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke kundërshtuar Aktvendimin nr.

01.3.2.2/12816/2020 të datës 25.11.2021, për shkak të shkeljeve absolute të dispozitave të LPA-së. Me plotësimin e padisë të datës 26.01.2024 ka kërkuar të anulohet në tërësi aktvendimi 03.01.1.2020/129/2 i datës 05.10.2020 dhe Aktvendimi 01.3.2.2/12816/2020 i datës 25.11.2021, ashtu edhe gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se AKPPM është institucion i RKS-së ashtu siç është edhe Dogana e Kosovës dhe një komunikim i mirëfilltë mes këtyre dy institucioneve me qëllim të zgjidhjes së kësaj çështjeje para se të vijë në gjykatë dhe një zbatim i urdhrave të dhënë nga Gjykata Themelore Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative do ta sqaronte paraprakisht këtë çështje dhe do ta vendoste ndryshe, po ta merrte dosjen e lëndës e paditura ku do të shihej si ka ardhur deri te leja e importit për substancë aktive. Ka shtuar se nuk besoj që është kryerja e detyrave të punës dhe përgjegjësi të tyre të qenurit komod me një email që është një rresht e gjysmë që është në shkresat e lëndës: “Albërije, AKPPM nuk ka dërguar asnjë dokument tjetër përveç atyre që i kanë dërguar herën e kaluar e ke edhe ti emailin, me respekt L...” e datës 11.11.2021. Një vendimi Doganës së Kosovës me të cilin një subjekt ekonomik e ngarkon me 231,000.00 euro mbivlerësim për të ardhur për te ai, është dashur që të shfrytëzojë të gjitha mjetet e veta konform ligjit duke përdorur edhe ato të institucioneve tjera relevante si dhe duke zbatuar edhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore nëse asgjë tjetër ta marrë gjithë dosjen për qasje në dokumente zyrtare dhe atë ta analizojë se si ka ardhur deri te leja e importit për substancë aktive. Për të sqaruar gjykatën edhe email-at edhe takimet e referuara në vendimin si dhe në deklaratimet e kësaj seance i takojnë një periudhe para nxjerrjes së aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë, konkretisht referimi i palës së paditur, email-it të D.Z. është i datës 20.09.2020, plot 14 muaj para nxjerrjes së aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë. Në fjalën përfundimtare ka shtuar se paditësit vazhdon t’i shkaktohet dëm pasi që paditësi për çdo ditë për strehim të kamionit të kompanisë SAGA D.O.O. që nga viti 2020, i cili kamion ishte i destinuar të sjellë mallin sipas kërkesës së paditësit, i cili përveç që faturohet nga e paditura faturohet edhe nga vet kompania SAGA. Gjykatës i ka propozuar që të anulohet këtë vendim si të pabazuar në ligj dhe të dëmshëm për paditësin.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 15.04.2024, e konteston në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. E paditura shtoi se aktvendimi është marrë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi dhe se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse nuk ka vërtetuar pretendimet e veta me asnjë provë. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetin në tërësi

pranë përgjigjes në padi në të cilën e kundërshtojmë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar pasi që aktvendimi i atakuar me padi është marrë konform dispozitave ligjore dhe i mbështetur në prova materiale. Gjithashtu kundërshtojnë të gjitha pretendimet e cekura në padi dhe plotësimin e padisë dhe parashtrësës së datës 14.05.2024 dhe në veçanti deklarohemi për pikën 10 dhe japim sqarimet se ky pretendim i paditësit nuk ka të bëjë me çështjen kontestuese, situatë tjetër që nuk ka të bëjë me çështjen kontestuese dhe për të cilën pala këtu paditësi ka mundur të shfrytëzojë mjetet e rregullta juridike pranë të paditurës ashtu siç është e rregulluar me nenin 291 të KDA-së dhe i propozoj gjykatës që të trajtojë lëndën kontestuese që këtu është me padi konform nenit 43 të LKA që do të thotë të trajtojë provat dhe objektin e kontestit të zhvilluar pranë të paditurës. E paditura gjatë analizimit të parashtrësave të paditësit ka vërejtur se thujtse të gjitha pretendimet e paditësit janë të adresuara ndaj zyrtarëve të AKPPM-së dhe e paditura nuk ka kompetenca që për të njëjtat të përgjigjet pasi që Dogana e Kosovës është organ ekzekutiv dhe ka për obligim të zbatojë vendimet të cilat kërkohen me dispozita ligjore. Gjatë kontrollës të anës dokumentare për DUD kontestues në lëndë nuk kanë qenë autorizimi për import të alkoolit medicinal, por vetëm autorizimi për import të substancës aktive dhe e paditura bazuar edhe në sqarimet e sektorit të tarifës të dhëna me datën 02.10.2020 ndër të tjera është cekur se importuesi duhet të pajiset me autorizim të alkoolit medicinal për kodin tarifor 22072000 10. E paditura pas administrimit të provave të cekura më lart ka marrë aktvendim të drejtë dhe të bazuar pasi që edhe në rivendosje ka marrë përgjigje nga zyrtarët e AKPPM-së mbi bazën e të gjitha shkresave të lëndës është marrë vendim i drejtë. Kundërshtoj pretendimet e palës paditëse ku e citon vetëm një email që është cituar më lart nga paditësi, ndërsa nuk citon ose nuk ka marrë për bazë që pas këtij email-i janë edhe tri komunikime ku është kërkuar nga zyrtari i rastit tek udhëheqësi SRV-së komunikimi këto të bëra me datë 23.11.2021 ku është kërkuar që të kërkohet edhe një herë nga zyrtarët e AKPPM-së që të përgjigjen në kërkesën e doganës. Po të njëjtën ditë është adresuar kërkesa tek AKPPM dhe nga AKPPM të njëjtën ditë kemi pranuar përgjigjen e datës 23.11.2021 ora 3:25 pasdite ku citoj “të bashkangjitur keni dokumentacionin e kërkuar nga ana e juaj si dhe sqarimin për llojin e aplikimit në email-in e mëposhtëm” dhe të gjitha janë të elaboruara në aktvendimin e atakuar me padi. Gjykatës i ka propozuar që të refuzojë kërkesëpadinë dhe padinë e paditësit duke e lënë në fuqi aktvendimin e atakuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 17.05.2024 ka administruar provat relevante si në vijim: Aktvendimi 03.1.1.20/129/2 i datës 05.10.2020, Aktvendim 01.3.2/12816 i dt. 26.10.2020, Aktgjykim A.nr. 1918/2020, Aplikim për import dt. 12.04.2024, Autorizimet për import të substancave aktive, Formularet SA, Vendimi i Qeverisë nr. 16/20, Ekspertizë financiare, Tariku Kartelat e artikullit, Certifikatë e regjistrimit në ARBK për paditësin, Kërkesë për zhvillim të procedurave hetimore dt. 05.10.2020, Komunikimet me email të siguruara nga e paditura, DUD-at: R 63533, R 20753, R 11165, Sqarim të klasifikim tarifor 02.10.2020, Raport informativ dt. 18.10.2020, Komunikimet me email të siguruara nga paditësi në plotësimin e padisë, Kallëzim penal, Ekstrakt nga aplikacioni nga AKPPM, Vendim nr. 23/31713/-1-ZSP/23 dt. 06.07.2023, Kërkesë për përmirësim të vendimit 3173/23-2, DUD R 6475, Pagesat ndërkombëtare dhe faturat Ekstrakt nga aplikacioni barnatari i dt. 16.09.2019, Email i dt. 05.08.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, dhe shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Pala paditëse me ankesën e datës 14.10.2020 drejtuar te paditurës ka kundërshtuar vendimin nr.03.1.1-2020/129/2 datë 05.10.2020 i lëshuar nga Sektori i Kontrollit Pas Importues, me arsyetimin se kontrolli pas importues ka vepruar në kundërshtim të plotë me Kodin Doganor dhe të Akcizave 03/L-109. Kontrolli pas importues vendimin e ka bazuar në sqarimin e klasifikimit tarifor të Sektorit të Tarifës. Si fakt i nevojshëm për rishqyrtim ankuesi e konsideron e-mailin zyrtar dt.15.07.2020 të dërguar nga ana e AKPMM i cili udhëzon palën që në vend të aplikacionit për pajisje me autorizim për leje për alkool të denatruar për përdorim medicinal, i cili aplikacion sipas AKPMM ka të bëjë vetëm me paketim final të tij, duhet zgjedhur dhe përdorur aplikacioni për substancë aktive, që sipas palës nënkupton se i ka parapri udhëzimi zyrtar i AKPMM-së. Pala ka paraqit formularët SA të AKPMM datat 09.10.2019, 04.03.2020 dhe 30.04.2020 në pjesët referencë 160669, 186830, që kanë të bëjnë me përshkrimin e substancës aktive në kuadër të listimeve të veçorive tjera identifikuese të mallit si substancë aktive para se gjithash figuron referenca në

emërtimin alkool etilik i denaturuar 96% pra ekziston pajtueshmëri e plotë mes aplikimeve për import të substancës aktive.

E paditura vendimet e veta i ka mbështetur kryesisht në Sqarimin e klasifikimit tarifor të datës 02.10.2020 i lëshuar nga Sektori i Tarifës-Dogana e Kosovës, me të cilin dokument zyrtar theksohet se subjekti ka paraqit autorizimin për import të substancave ndihmëse bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.03/2015 për Licencimin e prodhuesve të pajisjeve meridionale, duke e klasifikuar produktin në nënndarjen 22072000 10 për përdorim meridional, licencë kjo që nuk ka të bëjë me importin e alkoolit etilik të denaturuar për përdorim medicinal.

Gjykata edhe në procedurën e parë gjyqësore por edhe në këtë procedurë, konstaton se Sektori i Tarifës i të paditurës, ka bërë një sqarim duke u bazuar vetëm në dokumentacionet përcjellës të lëndës, importeve të mallrave identike. Gjykata konstaton se kemi veprime kontradiktore të dukshme nga ana e AKPPM-së, kur në njërën anë e udhëzon palën paditëse, të zgjedh aplikacionet për leje importi për substancë aktive, duke ia mohuar aplikacionin e deklaruar për alkoolin medicinal të denaturuar, dhe tani pasi që AKPPM-ja, ka lëshuar Autorizimet për import të substancës aktive për paditësin, e paditura Dogana e Kosovës Sektori i Tarifës nxjerr një sqarim me shkrim me arsyetimin se paditësi ka paraqit Autorizimin për import të substancave aktive-ndihmëse, që nuk ka të bëjë me importin alkool etilik të denaturuar për përdorim medicinal.

E paditura sipas aktgjykimin A.nr.1918/20 të datës 26.10.2021, ka qenë e detyruar të kërkojë informata shtesë përmes Kontrollit pas-importues, ashtu që të vërtetohen pretendimet e paditësit lidhur me parregullsitë eventuale të ndodhura me rastin e aplikimit për Licencë të importit të produkteve kontestuese të deklaruara me DUD-at R63533/09.10.2019, R11165/03.03.2020, R20753/25.04.2020, ashtu që pasi të sigurohet dosja e aplikacioneve të palës paditëse në AKPPM, dhe të merret një përgjigje zyrtare nga AKPPM, lidhur me ndryshimet që kanë ndodhur me aplikimin për Licencë të importeve nga paditësi, duke kërkuar nga e paditura që t'i vërtetojë konstatimet se obligimet doganore shtesë kundrejt paditësit, janë marrë mbi bazën e fakteve të drejta dhe të bazuara në ligj.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura nuk ka vepruar konform udhëzimeve nga aktgjykimi i lartcekur. E njëjta ka arsyetuar se më datë 08.11.2021, është kërkuar

nga Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale që të japë sqarime të kërkuara nga Gjykata Themelore Prishtinë në bazë të Aktgjykimit A.nr. 1918/20. Kërkesa ishte që të sigurohet dosja e aplikacionit të palës paditëse nga AKPPM dhe të merret një përgjigje zyrtare lidhur me ndryshimet që kanë ndodhur me aplikimin për licencë të importit nga "Gentipharm". Tutje ka sqaruar se me datë 11.11.2021, nga zyrtarët e AKPPM-së kanë pranuar përgjigje ku janë bashkëngjitur shkresat e mëparshme. Ndërsa me datë 23.11.2021, nga zyrtarët e AKPPM-së kanë pranuar përgjigje lidhur me kërkesën e Doganës së Kosovës për dokumentacionin e kërkuar. Dogana e Kosovës konstatoi se paditësi nuk plotësonte kërkesat për autorizim për paketim përfundimtar dhe kështu nuk përmbushte kriteret për "Autorizimin për Import të Alkoolit Medicinal (Të Denatruar). E paditura përfundoi se mallrat e importuara nuk kualifikoheshin për autorizimet e nevojshme për import, duke ndikuar në vendimin për të mbajtur qëndrimin fillestar të autoritetit doganor.

Për gjykatën arsyetimi se e paditura ka vepruar konform udhëzimeve dhe me datë 23.11.2021, nga zyrtarët e AKPPM-së kanë pranuar përgjigje lidhur me kërkesën e Doganës së Kosovës për dokumentacionin e kërkuar, është i paqëndrueshëm dhe i pa arsyetuar mjaftueshëm, ku nga provat e administruara rezulton se nuk kishte përgjigje të re, por vetëm është përcjellë komunikimi elektronik i vitit 2020 të cilin edhe më herët e ka poseduar e paditura dhe se e paditura nuk ka ndërmarrë veprime të mëtutjeshme për të kërkuar sqarimet dhe provat shtesë ashtu siç ishte e udhëzuar nga gjykata. Sipas provave në lëndë, rezulton se janë të bazuara pretendimet e paditësit se vendimi kontestues është marrë në dëm të palës e cila ka vepruar sipas udhëzimeve të organit kompetent. Po ashtu janë të bazuara edhe pretendimet e palës se e paditura ka vepruar ndryshe në raste të njëjta kur Dogana e Kosovës përmes aktvendimit kontestues ka konstatuar se alkooli i denatruar duhet të jetë në paketim final që të ketë leje përmes aplikacionit "Aplikacion për import të alkoolit të denatruar" dhe si i tillë mund të listohet në kodin tarifor pa akcizë 22072000 10 (pa akcizë), por në fakt Dogana e Kosovës më datë 18.10.2023 e ka kategorizuar në kodin doganor 22072000 10 (pa akcizë) si dhe ka zhdoganuar alkoolin e denatruar medicinal në paketim jo final, pra 1000 L me leje importi nga MMPHI. Gjykata pretendimin e tillë e mori si të bazuar pasi administroi si provë DUD-in R 67475 të datës 18.10.2023 dhe Lejen e Importit të alkoolit të denatruar medicinal lëshuar nga MMPHI për alkoolin nga prodhuesi Zaharani Zavodi e Bullgarisë. Prandaj, është i bazuar pretendimi i paditësit se për të njëjtën çështje, pa ndryshuar asnjë udhëzim

apo ligj lidhur me këtë çështje, Dogana e Kosovës, ka përdorur standard tjetër, duke e zhdoganuar pa akcizë alkoolin e denaturuar medicinal në paketim 1000L.

Gjykata sqaron se në konfliktin administrativ shqyrtohet ligjshmëria e aktit kontestues konform nenit 44 të LKA-së.

Nga provat e administruara dhe nga pretendimet e palës, gjykatës i rezultoi se vendimi kontestues është marrë duke mos u zbatuar vërejtjet dhe udhëzimet e gjykatës dhe se pretendimet e palës së paditur se paditësi shumicën e pretendimeve i ka të ngritura ndaj organit tjetër administrativ, dhe se e paditura nuk është organ hetues, i mori si të pabazuara pasi që e njëjta konform nenit 65 të LKA-së ka qenë e obliguar t'i përmbahet vërejtjeve të gjykatës dhe se e njëjta i është drejtuar AKPPM-së vetëm me një email dhe është mjaftuar me përgjigjen e njëjtë të cilën e paditura tashmë e kishte.

Andaj, rezulton se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt nga e paditura, gjithashtu me veprimet e mëvonshme me të cilat u çekën më lart kur e njëjta ka zhdoganuar mallin e njëjtë pa ngarkim të akcizës, rezulton të jetë praktikë e kundërt e organit të njëjtë për mallin e njëjtë, andaj për gjykatën kjo paraqet një veprim në dëm të palës, pretendimet e të cilës gjykata i mori si të bazuara ashtu që vendosi që të anulon vendimin kontestues si jo të drejtë dhe të pabazuar në ligj.

Në këtë rast gjykata konstaton se e paditura nuk iu ka përmbajtur dispozitave ligjore nga neni 86 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që parasheh: *“Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative.”*

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton se si rezultat i mos konstatimit të drejt të gjendjes faktike nga pala e paditur e cila nuk ka ndërmarr veprimet e duhura kur ka refuzuar ankesën dhe se nuk ka bazë ligjore në të cilën gjen mbështetje ky aplikim i akcizës nga Sektori i Akcizave-Dogana e Kosovës si organ faktik në procedurën administrative.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike, ballafaqimit dhe ekzaminimit të provave në shkresat e lëndës, gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara, të drejta e të ligjshme andaj në

tërësi aprovon kërkesëpadinë e paditësit dhe anulon vendimin kontestues 01.3.2.2/12816/2020 i datës 25.11.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe aktvendimi 03.1.1.2020/129/2 i datës 05.10.2020 me të cilin janë caktuar taksat shtesë, si vendim i pabazuar në ligj.

Vendimin që secila palë të bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, Gjykata, konform nenit 43, paragrafi 1, dhe nenit 46, paragrafët 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.247/22, datë 17.05.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.